



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:920382

Datë: 11.04.2024

Numri i dokumentit: 05636626

KE.nr.1634/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike të paditësit N.N.P “Valbona-GJ”, me seli në fshatin Llugagji, Komuna e Pejës, me NRB: 802724499, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Rifat Kelmendi, avokat me seli të zyrës në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Pejës, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Drita Sopi-Gashi, avokate me seli të zyrës në Prishtinë, me objekt kontesti pagesa e borxhit-kompensim i dëmit (çështja në rivendosje), vlera e kontestit 32,783.00 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 28.03.2024, në prani të autorizuarit të paditësit dhe të autorizuarit të të paditurës, me datë 11.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.N.P “Valbona-GJ”, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Pejës, që në emër të kompensimit të dëmit-borxhit, t’ia paguaj paditësit shumën prej 32,783.00 € (tridhjetë e dymijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tri euro), me kamatë ligjore prej 8 % të interesit vjetor e cila llogaritet për çdo ditë vonese deri në pagesën e dëmshpërblimit nga e paditura, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
- II. OBLIGOHET e paditura që paditësit t’ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore, dhe atë sipas Aktgjykimit II.EK.nr.431/2016, në shumën prej 2,720.00 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore sipas procedurës në rivendosje, për 7 seanca dhe atë secilën seancë nga 270.40 Euro, shumën e përgjithshme prej 1,892.80 Euro si dhe për precizimin e kërkesëpadisë 312 Euro, e në shumë të përgjithshme prej 4,924.80 Euro,

të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësi N.N.P “Valbona-GJ”, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, ka paraqitur padi ndaj të paditurës Komuna e Pejës, me të cilën ka kërkuar pagesën e borxhit të mbetur, në shumën prej 30,236.10 Euro.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktgjykimin II.EK.nr.431/2016, ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit N.N.P “Valbona-GJ”, ku në pikën I ka detyruar të paditurën që paditësit në emër të borxhit për punët e kryera nga kontrata me numër 16319/13/065/521, për rregullimin e “Memorialit Pavarësia”-Faza e tretë, paditësi t’ia paguaj shumën prej 21,160.25 Euro, në emër të borxhit dhe në emër të përgatitjes së materialit për kryerjen e punimeve të papërfunduara, me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në bankat komerciale të Kosovës në periudhë kohore prej një viti pa destinim të caktuar, duke e llogaritur nga data e ushtrimit të padisë deri në pagesën përfundimtare, që të gjitha brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit. Në pikën II ka refuzuar si të pabazuar pjesën e kërkesëpadisë së paditësit, në shumën prej 15,314.70 Euro, në emër të punëve të pa paguara dhe shumën prej 9,489.42 Euro në emër të kamatës së kërkuar për periudhën prej datës 12.03.2012 deri me datën 30.09.2016. Në pikën III ka detyruar të paditurën që palës paditëse t’ia paguaj shumën prej 2,100.00 Euro, në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit.

Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vendosur në procedurën ankimore sipas ankesës së palës paditëse dhe palës së paditur, me aktvendimin AC.nr.173/2019 të datës 08.07.2021, ka aprovuar ankesat e palëve ndërgjyqëse dhe ka prishur aktgjykimin e lartcekur dhe lënda i është kthyer gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit në padi, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se paditësi me të paditurën kanë qenë në marrëdhënie afariste reciproke sipas Kontratës për realizimin e Projektit “Rregullimi i Memorialit të Pavarësisë”-Faza e tretë, Nr.16139/13/065/521 të datës 11.10.2013, me të cilën kontratë paditësi ka marrë përsipër

të kryej punë të ndryshme ndërtimore me materiale të tij, ku e paditura nga çmimi bazë-fillestar i kontratës së lartpërmendur prej 74,869.06 Euro, me gjendje në ditën e parashtrimit të padisë, ka paguar shumën prej 44,632.96 Euro, kurse ka dështuar ta paguaj pjesën tjetër në shumë prej 30,236.10 Euro. Më tej ka theksuar se me ndërprerjen e kontratës në mënyrë të njëanshme nga e paditura, e njejta i ka shkaktuar paditësit dëm të konsiderueshëm material, pasi paditësit nuk iu ka kompenzuar borxhi i mbetur në emër të kryerjes së punëve të kontraktuara dhe punëve shtesë, e as materialet ndërtimore-shpenzimet dhe investimet e përmendura, si dhe ia ka pamundësuar edhe fitimin për pjesën e mbetur të porealizuar të kontratës, në shumë të përgjithshme prej 6,047.22 Euro. Paditësi me anë të parashtrësës së datës 28.03.2024 ka precizuar kërkesëpadinë sa i përket lartësisë, duke kërkuar nga e paditura borxhin në shumën prej 32,783.00 Euro. Andaj, mbi bazën e këtyre ka kërkuar aprovimin e kërkesëpadisë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës, në përgjigje në padi, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar për shkak se e njejta nuk ka mbështetje ligjore, juridike dhe faktike. Më tej ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet se Komuna e paditur në emër të kryerjes së punëve ndërtimore dhe shërbimeve tjera i ka borxh paditësit shumën prej 70,525.69 Euro, për faktin se për punët dhe shërbimet e kryera paditësit i është paguar shuma prej 44,632.96 Euro, e të cilin fakt e pohon edhe paditësi, mirëpo punimet dhe shërbimet tjera nuk i ka kryer paditësi në afatin e kontraktuar sipas kontratës së datës 11.10.2023. Ka shtuar se paditësi nuk i është përmbajtur dhe nuk i ka përmbushur detyrimet e kontraktuara. Në bazë të kontratës kontraktuesi duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve, dhe marrë parasysh këtë fakt kontraktuesi apo operatori ekonomik, e ka pasur të ndaluar të veprojë jashtë kësaj vlere dhe që të mos blejë kurrfarë materiali apo të mos porositë fuqi punëtore ashtu siç pretendon paditësi në padi, e të cilin material nuk e ka paraqitur asnjëherë me asnjë provë se çka dhe nga kush e ka blerë. I ka propozuar gjykatës që në tërësi ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë sepse Komuna e Pejës e ka përmbushur në tërësi detyrimin kontraktual.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata në rivendosje, me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor bëri administrimin e provave si në vijim:

- Kontrata me Nr.16319/13/065/521 e datës 11.10.2013;
- Raporti i vëllimeve të punimeve në kontratën e rregullimit të “Memoriali i Pavarësisë” i datës 11.10.2013;
- Ditari ndërtimor;
- Ekspertiza e ndërtimtarisë e datës 01.10.2018 e punuar nga eksperti N.M.;
- Ekspertiza financiare e punuar nga eksperti F.K. e datës 04.10.2018;
- Plotësimi i ekspertizës së ndërtimtarisë i datës 13.02.2019 dhe ajo e datës 21.02.2019,
- Plotësimi i ekspertizës financiare i datës 10.05.2023;
- Komunikimet në mes të operatorit ekonomik dhe Komunës së Pejës të datës 06.06.2013, dhe të datës 23.12.2014;
- Superekspertiza e datës 24.10.2023 së bashku me fotodokumentacionin.

Deklarimet e palëve ndërgjyqëse, si dhe provat tjera të prezantuara dhe të administruara, gjykata i vlerësoi të gjitha një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe gjeti se:

Nga deklaratimet e palëve ndërgjyqëse dhe provat e administruara, rezulton se për asnjërën palë nuk ishte kontestues fakti se me datën 11.10.2013 palët ndërgjyqëse kanë lidhur Kontratën për realizimin e Projektit “Rregullimi i Memorialit të Pavarësisë”-Faza e tretë, Nr.16139/13/065/521, me të cilën kontratë paditësi ka marrë përsipër të kryej punë ndërtimore ndërsa çmimi i kontratës ka qenë në vlerë prej 74,869.06 Euro.

Kontestuese për palët ishte sasia e punimeve të kryera nga paditësi, sipas kontratës së lartcekur, dhe poashtu pretendimi i paditësit se me rastin e ndërprerjes së kontratës nga e paditura, i është shkaktuar dëm i konsiderueshëm material dhe fitim i humbur, për shkak se paditësi për kryerjen e punimeve ka kontraktuar material me palët e treta.

Nga Raporti i vëllimeve të punimeve në kontratën e rregullimit të “Memoriali i Pavarësisë” i datës 11.10.2013 vërtetohet fakti se paditësi ka kryer punime ndërtimore në vlerë prej 59,554.10 Euro, ndërsa të përfunduara ka mbetur shuma prej 15,315.00 Euro, dhe se ndërprerja e njëanshme e punimeve është bërë nga ana e Autoritetit Kontraktues-Komuna e Pejës.

Nga super ekspertiza e datës 24.10.2023 e hartuar nga grupi i ekspertëve të ndërtimtarisë, Sh.M., S.B dhe L.D., vërtetohet fakti se punët e realizuara sipas kontratës dhe të paguara janë në vlerë prej 59,554.36 Euro, punët e porealizuara dhe të papaguara sipas kontratës janë në vlerë prej 15,314.70 Euro, punët shtesë të konstatuara nga menaxherja e projektit dhe ekspertët gjyqësor janë në vlerë prej 25,202.29 Euro, vlera e materialeve të furnizuara nga punëkryesi (paditësi) për realizimin e punimeve të porealizuara është 6,891.75 Euro, dhe vlera e shpenzimeve për mënjanimin e materialeve të mbetura në punishte është 689.00 Euro. Sipas grupit të ekspertëve vlera e borxhit të cilin e paditura duhet t’ia paguaj paditësit është në shumën prej 32,783.00 Euro.

Duke u bazuar në të gjeturat e super ekspertizës së punuar nga grupi i ekspertëve të ndërtimtarisë lidhur me kompensimin e dëmit-vlerën e borxhit, gjykata ia fali besimin të njëjtës, për faktin se është punuar në mënyrë profesionale dhe mbështetet në provat tjera të lëndës.

Në kontekstin e përgjithshëm të procedurës provuese, duke vlerësuar pretendimet e paditësit, respektivisht të autorizuarit të tij dhe kundërshtimet e të autorizuarit të të paditurit, lidhur me bazueshmërinë e kërkesëpadisë, gjykata ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, andaj të njëjtën e ka aprovuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Këtë qëndrim gjykata e ka marrë duke iu referuar dispozitave të nenit 136 të Ligjit NR. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), ku në par.1 përcaktohet se *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Ndërsa, në nenin 137 të LMD-së përcaktohet se *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”*.

Në rastin konkret, nga shkresat e lëndës është vërtetuar se edhe përkundër faktit se paditësi i është drejtuar të paditurës dy herë (me datë 06.06.2013, dhe me datë 23.12.2014) me kërkesën për sqarim të ndërprerjes së njëanshme të punimeve, gjegjësisht me kërkesë për zgjidhje të kontestit të krijuar, megjithatë e paditura nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim për përcaktimin e personave përgjegjës për këtë situatë të krijuar, por përkundrazi ka neglizhuar çdo kërkesë të drejtuar nga ana e paditësit, duke shmangur në këtë mënyrë përmbushjen e detyrimeve ndaj paditësit sipas kontratës së lartcekur, dhe rrjedhimisht me këto veprime e paditura i ka shkaktuar dëm material paditësit.

E paditura me asnjë provë nuk ka arritur të provojë se dëmi është shkaktuar pa fajin e saj, ashtu siç përcakton neni 136 par.1 i LMD-së, por përkundrazi e paditura vetëm e ka njoftuar paditësin se duhet t'i ndërprej punimet, dhe në këtë mënyrë ia ka pamundësuar paditësit t'i kryejë punimet për të cilat është zotuar sipas kontratës dhe për të cilat i njëjti ka krijuar shpenzime. Nga kjo situatë ekziston lidhja kauzale e drejtpërdrejtë ndërmjet veprimeve të të paditurës dhe pasojës së shkaktuar në rastin konkret. Andaj meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se dëmi-borxhi i cili është objekt i kërkesëpadisë, është shkaktuar nga ana e të paditurës, gjykata në aplikim të këtyre dispozitave ligjore dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit, t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar me rastin e borxhit të mbetur dhe dëmit të shkaktuar.

Sa i përket çështjes së kompensimit adekuat, gjykata i është referuar nenit 169 të LMD-së ku në par.1 përcaktohet se *“Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi”*. Ndërsa me par.3 të po të njëjtit nen përcaktohet se *“Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t'ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit”*.

Vendimin në lidhje me lartësinë e kërkesëpadisë gjykata e ka bazuar në raportin e ekspertizës së ndërtimtarisë, të punuar në këtë çështje juridike nga grupi i ekspertëve Sh.M., S.B dhe L.D., i cili grup ka konstatuar se vlera e borxhit të cilin e paditura duhet t'ia paguaj paditësit është në shumën prej 32,783.00 Euro. Rrjedhimisht, duke u bazuar në konstatimet e grupit të ekspertëve të ndërtimtarisë gjykata ka ardhur në përfundim se shuma e gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është kompensim real për dëmin që i është shkaktuar paditësit si rezultat i ndërprerjes së njënashme të kontratës nga ana e të paditurës.

Gjykata duke iu referuar nenit 382 të LMD-së, me të cilin përcaktohet se: *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”*, e miratoi kamatëvonesën e kërkuar, ashtu që e detyroi të paditurën që përveç shumës në vlerë prej 32,783.00 € në emër të kompensimit, paditësit t'ia paguajë edhe kamatën ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive.

Gjykata po ashtu vlerësoi edhe provat tjera të administruara lidhur me këtë çështje juridike, mirëpo ka gjetur se të njëjtat nuk janë me ndikim për vendosje në këtë çështje juridike.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurës, i referohen shumës së precizuar si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, dhe atë sipas Aktgjykimit II.EK.nr.431/2016 shpenzimet në shumën prej 2,720.00 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore sipas procedurës në rivendosje, për 7 seanca dhe atë secilën seancë nga 270.40 Euro, shumën e përgjithshme prej 1,892.80 Euro si dhe për precizimin e kërkesëpadisë 312 Euro, e në shumë të përgjithshme prej 4,924.80 Euro.

Nga arsyet e cekura më lartë, në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.1634/22, datë 11.04.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.